

REPUBLIKA E KOSOVES \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Prizrenin e Administretar

Direktorijati za Administraciju  
Yonetim Mudurlugu

1 HYRESE-ULAZ-GIRIS

10-320 N. 11975 D. 23-01-20




Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti




Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

## DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

### RAPORTI I PUNËS 2024



Dhjetor, 2024  
Prizren





Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural gjatë vitit 2024 i ka realizuar punët dhe detyrat e punës bazuar në prioritetet e përcaktuara me: Planin e Punës 2024, Planeve Zhvillimore, Strategjive Zhvillimore Lokale, Statutit të KK Prizren, Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, ligjeve, vendimeve, akteve tjera normative, kërkesave të ndryshme si dhe bashkëpunimin me shoqatat e fermerëve dhe grupet tjera.

Në vazhdimësi është punuar që të kemi bujqësi dhe Zhvillim Rural të reformuar, pjesë vitale dhe shumë e rëndësishme e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të komunës, me rritje të qëndrueshme të prodhimit, rritje të sigurisë ushqimore dhe cilësisë, marketing të përmirësuar të produkteve agro ushqimore dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore si toka, pyjet, ujërat dhe biodiversiteti.

I tërë aktiviteti i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është zhvilluar sipas sektorëve:

- **Sektori i Bujqësisë**
- **Sektori i Zhvillimit Rural**

DBZHR ka të punësuar 6 punëtorë me këtë strukturë profesionale dhe gjinore.





Përgatitja Profesionale	Numri i të punësuarve	Femra	Meshkuj
Agronom	3		3
Veteriner	1		1
Ekonomist	1		1
Shkolla E mesme	1	1	1
Gjithsej	6	1	5


Në procedur administrative, përmes zyrës së protokollit, janë pranuar gjithsej 2,068.00 lën kërkesa nga lami të ndryshe. Statusi i klërkesave të përpunuara është si në tabelë:

Statusi	Numri	%	Diagrami
Ne proces	23	1.10	
Miratuar	1088	52.43	
Refuzuar	915	44.095	
Hedhur poshtë	15	0.72	
Pezulluar	22	1.06	
Anuluar	12	0.57	
<b>Totali</b>	<b>2,075</b>		

Si kompetencë e deleguar nga Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të gjitha komunat, në kuadër të aplikimeve për pagesa direkte janë proceduar gjithsej 1,145 aplikime për të gjitha kategoritë subvencionuese. Gjithashtu, në vazhdimësi realizohet edhe regjistrimi me numër identifikues i fermerëve në sistemin elektronik, freskimi i të dhënave si dhe procedimi i certifikatave për aplikime për grande apo subvencione.

### Buxheti

Realizimi i projekteve kapitale, projekteve me bashkëfinancim, subvencioneve dhe mallra e shërbime janë zhvilluar sipas procedurave tenderuese dhe thirrjeve publike për aplikim për të gjitha kategoritë. Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive shpenzuese pasqyrohet si në vijim:





**I. Investimet kapitale**

Nr.	Emri i projektit	Përfitues/ fermerë	Kontrata €	Realizuar €	Për pagesë €
1	Rehabilitimi i rrugëve fushore		193,333.00	193,333.00	0
2	Rehabilitimi i kanaleve ujitëse		160,000.00	160,000.00	0
3	Ndërtimi i strehimores për qentë		0	0	0
<b>Gjithsej:</b>			<b>330,000.00</b>	<b>315,000.00</b>	<b>00</b>

**II. Projektet me bashkfinancim**


Nr	Emri i projektit	Përfitues/ fermerë	Kontrata €	Realizuar €	Për pagesë €	
1	Ngritja e serrave	25	109,710.00	109,710.	0	
2	Ngritja e pemishteve me pemë imta, dredhz mjeder	27	125,470.00	85,470.	0	
3	Ngritja e pemishte me peme te imta dredhz mjeder vazhdim	27	39,991.20	36,031.20	3,960.00	
4	Ngritja e pemishteve me pemë arrora	17	29,985.00	20,000.00	9,985.00	
5	Furnizimi me mekanizim bujqësorë	251	348,100.00	348,100.00	348,100.00	
<b>Gjithsej:</b>			<b>349</b>	<b>787,433.75</b>	<b>652,383.75</b>	<b>362,045.00</b>

**III. Subvencionet**

Nr	Emri i projektit	Përfitues	Kontrata €	Realizuar €	Për pagesë €
1	Subvencionimi i sektorit të bletarisë	151	77,999.00	77,999.00	0
2	Subvencionimi i aquakulturës	1	7,841.60	7,841.60	
3	Subvencionimi i qumështit, pula vojse	58	66,725.83	66,725.83	
4	Subvencionimi i deleve dhe dhive	119	100,065.00	100,065.00	
<b>Gjithsej:</b>			<b>329</b>	<b>277,536.90</b>	<b>0</b>

**IV. Mallra dhe shërbime**

Nr	Emri i projektit	Përfitues	Kontrata €	Realizuar €	Për pagesë €
1	Insemenimi artificial i lopëve, vaks. dele		97,500.00	97,500.00	0
2	Trajtimi i qenve endacak 2022-24		72,400.00	72,400.00	0
3	Trajtimi i qenve endacak 2024-26		72,400.00	29,874.00	
4	DDD i qytetit dhe zonat periferike		22,207.36	22,207.36	
5	Pjelloria e tokës		39,400.00	38,654.07	745,93.
7	Vaksini i deleve kundër brucelozës ,		68,400.00	68,400.00	5,000.00





kontrat korniz 2023-25				
		372,307.36	329,035.43	5,745.93
<b>Gjithsej:</b>		<b>372,307.36</b>	<b>329,035.43</b>	<b>434,516.76</b>
<b>TOTALI: I+II+III+IV =</b>				
<b>REALIZIMI</b>		<b>88.19%</b>		

**Drejtoria e Bujqësisë, dhe Zhvillimit Rural**

**Raporti i Punës 2024**

**-Sektori i Bujqësisë-**

Realizimin i projekteve kapitale, projekteve me bashkëfinancim, subvencioneve të financuara nga Kuvendi Komunal, monitorimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, organizimin e fushatës së korrje shirjeve, bashkëpunimin me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare për përmirësimin e pozitës së fermerëve, vlerësimin e dëmeve të fushës dhe dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe mbajtjen e evidencës për tokën bujqësore (të papunuar, të dhënë në shfrytëzim dhe të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit) kanë qenë aktivitetet kryesore të këtij sektori.

Përshkrimi i projekteve:


**I. Investimet Kapitale**

**1. “Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese”**

Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese janë ndër veprimet kryesore infrastrukturale sa i përket krijimit të kushte për kultivimin intensiv të kulturave bujqësore. Kjo ndërlidhet kryesisht me menaxhimin e sisteme lokale të ujitjes dhe kullimit jashtë shteteve të prodhimit të organizuar nga kompanitë regjionale të ujitjes. Ky projekt është realizuar në zonat kadastrale: Piranë, Vlashnje, Poslisht, Grazhdanik, Kabash Has, Krushë e Vogël, etj. Me këtë projekt janë rehabilituar 15 km. kanale ujitëse dhe 8 km. kanale kulluese. Vlera e projektit 160.000 €.

**2. “Rehabilitimi i rrugëve fushore”**

Përmirësimi i infrastrukturës në prona bujqësore është sfidë e vazhdueshme me të cilën po merret kjo drejtori. Rehabilitimi i rrugëve fushore ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja ka për qëllim zvogëlimin e shpenzimeve të transportit, lehtësimin i qasjes në tokat bujqësore, ruajtja e mekanizmit bujqësor, etj. Janë rehabilituar rreth 26 km. rrugë fushore në zonat kadastrale Piranë, Medvecë, Korishë, Krushë e Vogël, Zhur, Kobasj, Nashec, Atmaxhë, Randobravë, etj. Vlera e projektit 193,333.00 €





## II. Projektet me bashkëfinancim

### 4. “Ngritja e serrave me bashkëfinancim”

Ndryshmet e konsiderueshme klimatike që po ndodhin viteve të fundit, e që manifestohen me periudha të zgjatura të temperaturave të larta, dimrave me oscilime të mëdha klimatike, gjithnjë e më shumë fatkeqësi natyrore, erëra të forta dhe shira të përcjellë me breshër, kultivimin e perimeve në fushë të hapur e bëjnë gjithnjë e më të vështirë. Të gjitha këto dukuri po ndikojnë që sipërfaqet bujqësore të kultivuara me perime në fushë të hapur të kenë trend zvogëlimi.

Kultivimi i perimeve në ambiente të mbrojtura - serra është duke iu kushtuar vëmendje e posaçme për shkak të disa përparësive siç janë: furnizimi i tregut gjatë pranverës së hershme dhe vjeshtës së vonshme me perime të freskëta, siguria nga fatkeqësitë elementare, rendimenti i lartë, etj. Për këtë qëllim janë ngritur 15 serra 240m<sup>2</sup> dhe 10 serra 140 m<sup>2</sup> në bashkëfinancim me fermerët. Vlera e projektit 109,710.00€. Përfitues janë 25fermerë.

### 5. “Ngritja e pemishteve me pemë të imta- dredhëz mjedër, boronice” me bashkëfinancim


Keto projekte janë përfunduar 98% Rëndësia kryesore e projektit është furnizimi i tregut me prodhime të freskëta vendore, rritja e sipërfaqeve, rritja e mirëqenies të familjet fermere, zvoglimin e papunësisë, etj. Vlera e projektit 141,501.20 €.

### 6. “Ngritja e pemishteve me pemë arnore me bashkëfinancim”

Segment shumë i rëndësishëm i zhvillimit të bujqësisë në komunën tonë është kultivimi i pemëve arnore. Kjo është e bazuar në kushtet tona agroklimatike që mundësojnë një perspektivë dhe krijojnë bazë për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me investimet në këto fusha. Trendët e zhvillimit kanë të bëjnë me kultivimin e varieteteve konkurruese në treg, me potencial të lartë gjenetik, të rezistueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Rëndësia kryesore e projektit është furnizimi i tregut me prodhime të freskëta vendore, rritja e sipërfaqeve, rritja e mirëqenies të familjet fermere, zvoglimin e papunësisë, etj. Janë ngritur 5 ha. me arra dhe përfitues janë 17 fermer. Vlera e projektit 29,985.00 €.

### 7. “Furnizimi me mekanizim bujqësorë me bashkëfinancim”

Fermerët dhe ekonomitë familjare deri diku janë të pajisur me mekanizim të ndryshëm bujqësorë, por i njëjti nuk i plotëson kërkesat për prodhimtarisë intensive, pasi që është





i vjetruar dhe amortizuar në skajshmëri. Ka qenë më se e nevojshme që në këtë drejtim të marrim hapa konkret, duke i përcaktuar nën sektorët me prioritet, për përmirësimin gradual dhe afatgjatë të gjendjes në mënyrë që të krijohen kushte normale për prodhimtari intensive.

Përfitues janë 40 fermerë me motokultivator 4.4 kë,

## Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

*Raporti i Punës 2024*

Përfitues janë 25 fermer motokultivator 7.5 kë

Përfitues janë 80 fermer, freza 1.8 m.

Përfitues janë 40 fermer, Kosa rotative 135.

Përfitues janë 40 fermer spërkatëse 400 l .

Përfitues janë 22 fermer shpendarse plehu ,

Përfitues janë 5 fermer makina mbjellëse për grur

Përfitues janë 5 fermer makina mbjellëse për misër .

Vlera e projektit 348,100.00 €


### III. Subvencionet

Krizat e vazhdueshme ekonomike dhe politike në nivel global, kushtet klimatike me oscilime shume të mëdha gjatë vegjetacionit (vërshimet, erërat, ngricat) dhe disa faktor tjerë specifik (politikat fiskale të pafavorshme, qarkullimi i vështirësuar i mallrave, etj.) e kanë bërë shumë të vështir gjendjen e përgjithshme në bujqësi. Bazuar në këtë, subvencionimi i bujqësisë është i pashmangshëm në mënyrë që fermerët të operojn në kufij të rentabilitetit. Realizimi i subvencioneve ka filluar me publikimin e thirrjeve për aplikim për secilën kategori mbështetëse, në të cilat kanë qenë të përkrahura qëllimi, kriteret e përcaktuara që duhet përmbushur si dhe dokumentacioni përkatës.

Të gjitha Thirrjet për Aplikim për Fermerët e Komunës së Prizrenit për përfitim në kuadër të implementimit të projektit për subvencione kanë qenë të publikuara në faqen zyrtare të komunës. Pas përmbylljes së fazës së aplikimit janë formuar komisione përkatëse për vlerësimin e aplikimeve të pranuar, në përputhje me procedurat e brendshme duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë hartuar listat e përfituesve të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara.

Gjatë kësaj periudhe, zyrtarisht me numër protokolli janë regjistruar gjithësej 394 aplikime.

Nr.	Kategoria	Njësia	Sasia / Krerë/ litër kg.	Shuma € njësi	Gjithsej €
1	Subvencionimi i deleve dhe dhive	Krerë	20,013	5.00	100,065.00
2	Subvencionimi i bletëve, mjedër	Koshere	15,599.8	5.00	77,999.00
3	Subvenc. i aquakulturës - peshkut	Kg.	39,208.00	0.20	7,841.60
4	Subvencionimi i qumështit	litër	1,491,138	0.05	74,556.90
5.	Subvencionimi i shpendarisë	copë	19000	0.10	1.900.00
6.					





Të gjithë fermerët janë përfitues në vlerë të përgjithshme prej..... 326,362.50 €.

Realizimi i të gjitha projekteve është mbështetur në parimet bazë të garantuara me ligj sa i përket trajtimit të barabartë të të gjithë aplikuesve.

Të gjitha thirrjet për aplikim për shprehjen e interesit për subvencionimin e projekteve në kategori specifike janë publikuar në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelat për shpallje.

## Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

### Raporti i Punës 2024

Dorëzimi i aplikacioneve është bërë përmes zyrës për praninë e dokumentacionit në zarfe të mbyllura.

#### IV. Shërbimet

Nga kjo kategori janë realizuar 5 projekte:

- **Insemenimi afrificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve;** Janë inseminuar 3000 lopë qumështorë, dhe vaksinuar 18000 dele.
- **Trajtimi i qenve endacak.** Gjatë vitit 2024 janë trajtuar 800 qen endacak.
- **Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonat periferike;**
- **Vaksinimi i deleve e dhive kundër brucelozës.** Në vitin 2024 janë vaksinuar 20000 krer dele kundër brucelozës.
- **Pjelloria e tokës dhe rekomandim për plehra.** Janë bërë analizat e 2000 ha. tokë bujqësore në fshatrat komunës së Prizrenit.

në vlerë të përgjithshme prej 329,035.43€ (siç shihet edhe nga tab.).


Nga të gjitha këto shërbime përfitues të drejtëpërdrejtë janë qytetarët e komunës së Prizrenit si dhe një numër i konsiderueshëm i fermerëve rreth 546.

#### -Sektori i Zhvillimit Rural-

Zhvillimi rural paraqet një proces i grumbullimit të aktiviteteve që kanë për qëllim ngritjen e standardit të ekonomive bujqësore duke përfshirë edhe ato të diversifikimit rural si masë shtesë e rritjes së të ardhurave.

Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë në vazhdimësi po realizon projektin e shërbimeve këshillimore. Qëllimi i këtyre projekteve është që fermerët të bëhen të pavarur në menaxhimin e fermave të tyre.

Me këtë ne si komunë do të arrimë të bëjmë një klasifikim të plotë të kategorive të fermerëve që në të ardhmen të na shërbej në realizimin e projekteve madhore.






Përveç realizimit të objektivave të parapara nga drejtoria, sektori i Zhvillimit Rural ka bashkëpunuar edhe me shumë organizata qeveritare e jo qeveritare me qëllim të përmirësimit të situatës në fermat bujqësore dhe ekonomit rurale.

Në bashkëpunim me shoqata bujqësore dhe institucione publike e private kemi organizuar trajnime, seminare, ekspozita dhe manifestime tradicionale për promovim të vlerave të prodhimeve agro ushqimore përmes diversifikimit rural.

#### **Aktivitetet tjera:**


- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave. Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsej **10 trajnime** përmes
- projektit “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese”

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural varësisht prej nevojës është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, regional dhe qendror.



Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

*Raporti i Punës 2024*






Përveç realizimit të objektivave të parapara nga drejtoria, sektori i Zhvillimit Rural ka bashkëpunuar edhe me shumë organizata qeveritare e jo qeveritare me qëllim të përmirësimit të situatës në fermat bujqësore dhe ekonomit rurale.

Në bashkëpunim me shoqata bujqësore dhe institucione publike e private kemi organizuar trajnime, seminare, ekspozita dhe manifestime tradicionale për promovim të vlerave të prodhimeve agro ushqimore përmes diversifikimit rural.

**Aktivitetet tjera:**

- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave. Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsej **10 trajnime** përmes projektit “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese”
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural varësisht prej nevojës është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, regional dhe qendror.



**Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

*Raporti i Punës 2024*

Drejtori  
  
**Bexhat Bytyqi**

